



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafin 63.1.2. pikën a) si dhe lidhur me nenin 62 paragrafin 1 nënparagrafin d) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Uplift" Sh.P.K. të datës 18.05.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 15.05.2023 të autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rregullimi dhe riparimi i ashensorëve - Rivlerësim" me nr. të prokurimit 616-22-2435-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 026 211, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Uplift" Sh.P.K. e datës 18.05.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 15.05.2023 të autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rregullimi dhe riparimi i ashensorëve - Rivlerësim" me nr. të prokurimit 616-22-2435-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 026 211.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Uplift" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Uplift" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi) me datë 18.05.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 15.05.2023 të autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rregullimi dhe riparimi i ashensorëve - Rivlerësim" me nr. të prokurimit 616-22-2435-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 026 211.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) – *“në lidhje me stafin teknik mbi bazën e dëshmive të dorëzuar nga ne, në Raportin e Ekspertit Shqyrtues 522/22 përkatësisht Vendimin e Panelit Shqyrtues 522/22, konstatohet se ne si GOE përmbushim kërkesën e njoftimit për kontratë dhe dosje të tenderit për stafin teknik”*.

Pretendimi i dytë (II) – *“Në vendimin e datës 15.05.2023 nuk bazoheni në tërësi në provat shkresore dhe informacionet e dhëna në këtë aktivitet të prokurimit dhe veproni në mënyrë diskriminuese duke e marrë për bazë gjendjen e tanishme në mënyrë selektive. Pra në njërin anë nuk bëni vlerësimin e tenderit me dokumentet e dorëzuara në momentin e dorëzimit të tenderit përkatësisht nuk i merrni parasysh stafin i cili ka qenë i punësuar në momentin e dorëzimit të ofertave po konsideroni vetëm gjendjen e tanishme vetëm për stafin që është dorëzuar me ofertë”*.

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues – Komuna e Prishtinës në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 56, 59, 67, dhe 108/A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje “LPP”) si dhe nenin 40 paragrafi 40.3, nenin 59 dhe 67 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje “RRPP”).

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 26.05.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

Lidhur me pretendimin e parë (I) fillimisht duhet sqaruar se me datë 29.12.2022 OSHP ka marrë vendimin nr. 522/22 përmes të cilës ka miratuar si të bazuar ankesën e parashtruesit ashtu që ka kthyer në rivlerësim këtë aktivitet të prokurimit. Parashtruesi pretendon se OSHP përmes këtij vendimi ka konstatuar se parashtruesi e ka përmbushur “kërkesën e njoftimit për kontratë dhe dosje të tenderit për stafin teknik”. Nga administrimi i vendimit të OSHP si provë materiale në këtë rast është gjetur se autoriteti kontraktues ka përmbushur në tërësi vendimin e OSHP në momentin kur e ka kthyer në rivlerësim aktivitetin përkatës të prokurimit. Çështja e vlerësimit të përmbushjes së kriterëve të dosjes së tenderit është kompetencë ekskluzive e komisionit të vlerësimit. Kjo nënkupton që vlerësimi i përmbushjes së kriterëve të DT nga tenderuesit nuk mund të bëhet as nga OSHP dhe nga asnjë autoritet tjetër përveçse komisionit të vlerësimit në përputhje me LPP dhe legjislacionin sekondar në fuqi. Pikërisht për këtë arsye OSHP në asnjë pjesë të vendimit të vet nuk është lëshuar në vlerësimin, ekzaminimin apo krahasimin e tenderuesve në këtë aktivitet të prokurimit. OSHP në vendimin e vet ka vendosur të kthej në rivlerësim aktivitetin e prokurimit dhe këtë vendim e ka respektuar në tërësi autoriteti kontraktues. Vlerësimi i përmbushjes së kriterëve të DT bëhet nga komisioni sipas LPP.

Njëkohësisht është administruar si provë materiale edhe raporti i komisionit rivlerësues për këtë aktivitet të prokurimit dhe me këtë rast është gjetur se komisioni ka bërë vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderuesve në përputhje me LPP dhe legjislacionin sekondar në fuqi. Ky fakt nuk është kontestuar as nga vet parashtruesi përderisa në kërkesën për rishqyrtim nuk ka potencuar se përmes cilit veprim komisioni për rivlerësim ka mund të ketë bërë shkelje të dispozitave ligjore në fuqi. Përkundrazi parashtruesi përmes pretendimit të vet aludon se komisioni për rivlerësim është dashur që të mos eliminoj parashtruesin për shkak të vendimit të OSHP të cituar më sipër. Megjithatë OSHP përmes vendimit të vet nuk ka rekomanduar që autoriteti kontraktues duhet të shpall si fitues parashtruesin. Njëkohësisht as nuk ka rekomanduar që të mos eliminohet parashtruesi nga ky aktivitet i prokurimit. Me fjalë të tjera OSHP përmes vendimit të vet nuk është lëshuar fare në çështjen se kush është tenderues i përgjegjshëm dhe kush jo. OSHP vetëm ka marrë vendim që ky aktivitet i prokurimit duhet të kthehet në rivlerësim. Në anën tjetër autoriteti kontraktues ka vepruar pikërisht në këtë mënyrë duke rivlerësuar aktivitetin e prokurimit. Ky fakt nuk kontestohet as nga parashtruesi. Për këtë arsye ky pretendim i parashtruesit është tërësisht i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e dytë (II) fillimisht duhet cekur se parashtruesi nuk ka treguar se cilat shkresa dokumentare janë marrë për bazë në mënyrë selektive siç pretendohet. Pra cilat janë ato dëshmi të ofruara (të listuara dhe cituara konkretisht) që janë marrë parasysh nga komisioni vlerësues dhe cilat jo. Në anën tjetër me rastin e administrimit të njoftimit mbi vendimin si provë materiale në këtë rast është gjetur se në arsyetimin e letrës standare për tenderuesin e eliminuar është evidentuar se *“ju keni dorëzuar një listë të stafit të ri, të cilët tani janë të angazhuar në punë mirëpo nuk janë marrë parasysh sepse ata punëtor nuk kanë qenë pjesë e dokumentacionit të dorëzuar me ofertë”*. Lidhur me arsyetimin e cituar si më sipër duhet shtuar se nuk mund të merret parasysh asnjë dëshmi apo dokument që dorëzohet nga tenderuesit në kundërshtim me LPP dhe RRPP pas përfundimit të afatit për dorëzimin e ofertave. Në të kundërtën AK do të vepronte në kundërshtim me LPP dhe RRPP. Prandaj komisioni vlerësues ka vepruar në mënyrë të drejtë me rastin kur nuk ka marrë parasysh dokumentet e dorëzuara nga cilido prej tenderuesve pas përfundimit të afatit për dorëzimin e ofertave sipas LPP. Për këtë arsye ky pretendim i parashtruesit është tërësisht i pabazuar.

Sipas trajtimit dhe elaborimeve më lartë në këtë vendim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të RRPP.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 26.05.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.